




KOMPANIA RAJONALE E UJËSJELLËSIT


REGIONAL WATER COMPANY Kompania Rajonale e Ujës

BIFURKACIONI ShA "BIFURKACIONI SH.A."

Ferizaj



Tel. +383 (0) 290 320 650, Tel&Fax. +383 (0) 290 321 119, e-mail: info@bifurkacioni.com, www.bifurkacioni.com




PLANI I BIZNESIT TË KRU "BIFURKACIONI" ShA. PËR PERIUdhËN 2023-2025

Vendimi: 6-1

Bordi i Drejtorëve të KRU Bifurkacioni ShA. i emëruar me vendimin e Qeverisë nr. 06/92, i dates: 10.08.2022, në mbledhjen e mbajtur më datë: 31.10.2022, pas shqyrtimit dhe finalizimit paraprak të Planit të Biznesit të KRU Bifurkacioni ShA. për periudhën 2023-2025, unanimisht e aprovoj Planin e Biznesit (2023-2025).

Planin e Biznesit do të dorëzohet në NJPMNP në kuadër të Ministrisë së Ekonomisë.

	Delegoj	Aprovoj
Emri dhe mbiemri	Jeton Shabani Kryeshef Ekzekutiv	Kryesuesi i BD-së Naim Rexhaj
Nënshkrimi		
Datë:	31.10.2022	31.10.2022



Adresa: Rr. Enver Topalli 45, Ferizaj 70000



KOMPANIA RAJONALE E UJËSJELLËSIT
REGIONAL WATER COMPANY
BIFURKACIONI ShA
Ferizaj

PLANI I BIZNESIT

2023 - 2025



Ferizaj

tetor, 2022

PLANI I BIZNESIT 2023 - 2025

Ferizaj
tetor 2022

Përmbajtja

Fjala e menagjmentit.....	6
Hyrje	8
Historiku i kompanisë.....	8
Deklarata e politikës	9
Qëllimet, bjektivat strategjike afatgjata dhe afatshkurtëra	9
1.Vlerësimi i performancës së vitit paraprak 2022	11
1.1 Shërbimi operativ - teknik	11
1.2 Financat dhe shërbimi i shitjes	12
1.3 Burimet njerëzore	12
2. Plani Operativ	13
2.1 Parashikimi i kërkesës për ujë të pijes dhe për grumbullim - trajtim të ujërave të ndotura	13
2.2 Trajtimi, cilësia dhe shpërndarja e ujit të pijes	14
2.3 Cilësia e ujit të shpërndarë.....	17
2.4 Grumbullimi i ujërave të ndotura	17
3.Plani i shitjes.....	18
3.1 Përdatësimi i bazës së të dhënave.....	19
3.2 Instalimi i ujëmatësve	19
3.3 Rritja e saktësisë së leximit të ujëmatësve.....	19
3.4 Faturimi	19
3.5 Arkëtimi.....	19
3.6 Marrëdhëniet me konsumatorë	20
3.7 Komunikimi me publikun.....	20
4.Plani i financave.....	21
4.1 Analiza e të ardhurave	21
5.Plani i zhvillimit të stafit dhe sistemit informativ menaxhues.....	26
5.1 Struktura organizativ	26
5.2 Plani i trajnimit të stafit	26
5.3 Plani i stimulimit të stafit	27
5.4 Plani i zhvillimit të sistemit infomativ menaxhues.....	27
6.Plani i menaxhimit të aseteve	28
7.Plani i investimeve.....	29
Shtojcat	33
Shtojca Ia: Të dhënat dhe caqet e performancës mujore në 2023	34
Shtojca Ib: Të dhënat dhe caqet e performancës vjetore në 2023 – 2025	35
Shtojca III: Planet e veprimeve 2022	36

Shkurtesat

ARRU	-----	Autoriteti Rregullator për Shërbimet e Ujit
BD	-----	Bordi i Drejtorëve
DF	-----	Departamenti i Financave
DHU	-----	Departamenti i Humbjeve të Ujit
DO	-----	Departamenti Operativ
DMA	-----	District Measured Area (Zonë e Matur)
DSh	-----	Departament i Shitjes
DShK	-----	Departamenti i Shërbimeve për Konsumatorë
GIS-SIGJ	-----	Geografic Information System (Sistemi i Informacionit Gjeografik)
IKShPK	-----	Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës
ILI	-----	Infrastructure Leakage Index (Indeksi i Rrjedhjeve Infrastrukturore)
ITUP	-----	Impianti i Trajtimit të Ujit të Pijes
KE	-----	Kryeshefi Ekzekutiv
KNMU	-----	Këshilli Ndërmintor i Ujërave
KRU-B	-----	Kompania Rajonale e Ujësllësit Bifurkacioni
KRUK-B	-----	Kompania Rajonale e Ujësllësit dhe Kanalizimit Bifurkacioni
MPMS	-----	Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale
MP	-----	Marrëdhëniet me publikun
MTI	-----	Ministria e tregtisë dhe Industrisë
MZHE	-----	Ministria e Zhvillimit Ekonomik
NKS	-----	Numri i konsumatorëve të synuar
NjK	-----	Njësia e kontrollit
NP	-----	Ndërmarrja Publike
OShP	-----	Organizata Shoqërore Publike
PAI	-----	Plani Afatgjatë i Investimeve
PV	-----	Plani i Veprimit
RWSSP	-----	Rural Water & Sanitation Support Programme (Programi Mbështetës për Ujësllës dhe Kanalizim në Zonat Rurale)
ShA	-----	Shoqëri Aksionare
ShUKOS	-----	Shoqata e Ujësllësve dhe Kanalizimeve të Kosovës
TI	-----	Teknologjia Ingformative
TM	-----	Tre Mujori
UPF	-----	Uji i pa faturuar
UNMIK	-----	United Nations Mission in Kosovo (Misioni i Kombeve të Bashkuara në Kosovë)

Fjala e menagjmentit

Plan i Biznesit 2023 - 2025 është hartuar për të përafruar objektivat strategjike zhvillimore të kompanisë dhe **Planin Afatgjatë të Investimeve (PAI) 2019-2028**, të hartuar nga **Kompania Rajonale e Ujësjellësit Bifurkacioni (KRU-B)**, për një kornizë kohore 10 vjeçare.

Në vitin aktual financiar është duke u zhvilluar progres i mëtijshëm dhe deri tashti KRU-B është në drejtim të përmbushjes së qëllimeve të veta afatgjata, ndër të cilat, qëllim parësor është sigurimi i shërbimeve sipas standardeve të përcaktuara nga **Autoriteti Rregullator për Shërbimet e Ujit (ARRU)**.

KRU-B po e zgjeron rolin e vet në ofrimin e shërbimeve të ujit në vazhdimsi, duke kontribuar në përmirësimin e jetesës së të gjitha komuniteteve. Këto përmirësime janë duke u zhvilluar dhe do të përfundojnë gjatë dekadës së ardhshme, duke rezultuar në rritjen e mbulueshmërisë me shërbime dhe rritjen paralele të kapaciteteve të burimeve ujore dhe trajtimit të ujit.

Objektiivi për furnizim të gjithë zonës së shërbimit me ujë cilësor të pijes, sipas standardeve të përcaktuara nga **Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike (IKShPK)**, mbetet njëri prej objektivave kryesore dhe më të rëndësishëm të KRU-B.

Menaxhmenti i KRU-B zotohet të implementoj këtë plan dhe planifikon të bëjë mbikëqyrjen e tij në baza mujore dhe tremujore, ndërsa sipas nevojës çdo gjashtë muaj do të bëhet rishikimi i planeve të veprimeve me qëllim të përmbushjes së planit njëvjeçar të vitit 2023.

Gjatë periudhës planifikuese 2023 – 2025 pritet të zgjerohet zona e mbulimit me shërbime të ujësjellësit dhe grumbullimit të ujërave të ndotura, duke përfshirë edhe ato pjesë të cilat do të duhej të inkuadroheshin në zonën e përgjithshme të shërbimit gjatë viteve të kaluara. Deri në fund të vitit 2025 përqindja e furnizimit me ujë të pijes dhe grumbullim të ujërave të ndotura do të jetë rreth 81% - 85% nga 79% - 84% sa është aktualisht, ndërsa pritet të shtohet numri i konsumatorëve për rreth 4,499.

Gjatë viteve 2023-2025 KRU-B planifikon të përmirësojë furnizimin me ujë të pijes për konsumatorët ekzistues dhe ata të rinjë në 24 orë të kontinuitetit të furnizimit, duke përfshirë edhe përmirësimin e furnizimit me ujë të pijes gjatë sezonit të verës.

Gjatë periudhës planifikuese 2023 - 2025 KRU-B do të vazhdon me ndërmarrjen e aktiviteteve konkrete për kontrollimin e ujit të trajtuar i cili ju shpërndahet konsumatorëve, duke ndërmarrë masat e duhura për zvogëlimin e humbjeve teknike (fizike) dhe komerciale (administrative) të ujit apo të **„ujit të pafaturuar” (UPF)**.

Faturat do t’ju lëshohen çdo muaj të gjithë konsumatorëve të regjistruar aktiv, duke vazhduar me faturimin e bazuar në lexim të ujëmatësve. Do të punohet edhe në përdatësimin e bazës së të dhënave pas inspektimit të të gjithë konsumatorëve dhe atyre pasiv.

Në vitin 2023, KRU-B do të vazhdojë me aplikimin e politikave të duhura me qëllim të ngritjes së normës së përgjithshme të arkëtimit deri në 93%, (për ekonimi familjare deri në 92%, për bizneset deri në 100% dhe për institucionet deri në 100%).

Të ardhurat dhe shpenzimet e KRU-B janë analizuar nga secila qendër e të ardhurave / shpenzimeve dhe për t’i arritur qëllimet e saja kryesore, KRU-B planifikon që në krahasim me vitin 2022, në vitin 2023 t’i rritë të ardhurat e arkëtuara.

Të ardhurat e krijuara do të mjaftojnë për mbulimin e të gjitha shpenzimeve operative dhe nevojave për investime kapitale të parapara për periudhën planifikuese.

Burimet njerëzore do të vazhdojnë të marrin trajnimet e duhura, varësisht prej nevojës dhe në përputhje me arritjen e synimeve afatshkurtëra dhe afatmesme të KRU-B, sikurse edhe vazhdimin e mëtejshëm të avancimit të sistemit të teknologjisë informative.

Planifikimet financiare të të ardhurave dhe shpenzimeve akruale janë paraqitur më hollësisht në Shtojcën Shtojcën II Ia dhe Ib të këtij dokumenti., ndërsa planet e veprimeve në Shtojcën III.

Stafi menagjues

KRU BIFURKACIONI SHA

Hyrje

Historiku i kompanisë

KRU-B është ndërmarrje publike për ofrimin e shërbimeve të furnizimit me ujë të pijes dhe grumbullimin e ujërave të ndotura.

Fillimisht, KRU-B është themeluar si ndërmarrje për grumbullimin e mbeturinave, në vitin 1952. Në vitin 1961 është përruar Fabrika e Prodhimit dhe Trajtimit të Ujit në Pleshinë, e cila në vitin 1966 është marrë në menaxhim nga kjo ndërmarrje, në statusin e ndërmarrjes shoqërore-shtetërore me emërtimin **ZVEZDA (në gjuhën shqipe YLLI)**, emërtim të cilin e ka mbajtur deri në vitin 1999, kur transformohet në **Ndërmarrje Publike (NP)** për ofrimin e shërbimeve të ujësjellësit, kanalizimit dhe grumbullimit të mbeturinave nën menaxhimin e Shtyllës së IV të **Misionit të Kombeve të Bashkuara për Administrimin e Kosovës (UNMIK)**, si Ndërmarrje Komunale Publike e emërtuar si **Organizata Shoqërore Publike (OSHP) HIDRO-HIGJIENA**.

Në nëntor të vitit 2003, OSHP HIDRO-HIGJIENA ndahet në dy kompani të reja dhe të pavarura publike: në NP **Kompania Rajonale e Ujësjellësit dhe Kanalizimit BIFURKACIONI (KRUK-B)**, e cila merret vetëm me shërbimet e ujësjellësit dhe kanalizimit dhe në kompaninë tjetër publike: NP Rajonale për Mbeturina PASTËRTIA, e cila merret me mirëmbajtjen e pastërtisë dhe grumbullimin e mbeturinave. Në pjesën e parë të vitit 2004, KRUK-B regjistrohet nga Qeveria e Kosovës, respektivisht nga **Ministria e Tregtisë dhe Industrisë-MTI (Vendimi i KRUK BIFURKACIONI Nr. 793 i datës 17.09.2004)**.

Me vendim të Qeverisë së Kosovës, gjegjësisht MTI-së, më 31 Maj të vitit 2007 KRUK-B transformohet në **Shoqëri Aksionare (ShA)** të Komunës së Ferizajt me 85.30% të aksioneve dhe të Komunës së Kaçanikut me 14.70% të aksioneve. Deri në 31 Qershor 2008, kjo kompani është mbikëqyrur nga Agjencioni Kosovar i Mirëbesimit, ndërsa pas kësaj date mbikëqyret nga Komunitat e Ferizajt dhe Kaçanikut.

Në mars 2009, në mënyrë të njëanshme dhe të kundërligjshme u pavarësua njësi e Kaçanikut, duke u ndarë nga KRUK-B dhe duke u emërtuar me emërtimin LYPETENI, ndërsa ribashkimi është bërë në janar 2015.

Me kërkesën e ish-Zyrës Rregullatore të Ujësjellësit dhe Kanalizimit (tash Autoriteti Rregullator për Shërbimet e Ujit-ARRU) dhe duke u bazuar në Ligjin Nr. 04/L-111 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 03/L 087 për Ndërmarrjet Publike, në mbledhjen e Bordit të Drejtorëve të datës 16.04.2014 merret vendim për ndryshimin e emërimit të kompanisë nga KRUK Bifurkacioni ShA në KRU Bifurkacioni ShA (**Procesverbali i Mbledhjes së 6-të të Bordit të Drejtorëve, i datës 16.04.2014**).

KRU-B posedon licencën për kryerjen e veprimtarisë së saj, të lëshuar më 25.09.2018, me numër L-06/2018, nga ARRU për periudhën 2018-2026.

Deklarata e politikës

Vizioni i KRU-B është përqëndrimi në kënaqjen e konsumatorëve me nivelin e shërbimeve të ofruara. Misioni i përgjithshëm i KRU-B është që të sigurojë ujë cilësor dhe të mjaftueshëm të pijes për të gjithë konsumatorët, pa dallim race, gjinie dhe religjioni. Vlerat kryesore të KRU-B janë: përkushtimi i stafit për ofrimin e shërbimeve cilësore ndaj konsumatorëve, vetëqëndrueshmëria financiare dhe të qenit transparent ndaj akterëve relevant të sektorit të ujit në Kosovë.

KRU-B angazhohet për zgjerimin e rrjetit të furnizimit me ujë dhe grumbullimit të ujërave të ndotura, si dhe për gjetjen e mundësive të ndërtimit të impiantit të trajtimit të ujërave të ndotura përmes burimeve të jashtme të financimit. KRU-B zotohet për shfrytëzimin racional të burimeve të ujit dhe mirëmbajtjen e rregullt të rrjetit të ujësllësit dhe kanalizimit.

Implementimi i misionit të kompanisë mund të përcillet me rreziqet eventuale të natyrave të ndryshme sikurse janë:

- Mungesa e ujit në burime, si pasojë e mungesës së reshjeve atmosferike;
- Krizat sociale-ekonomike në nivel të vendit ose lokale;
- Pandemia COVID-19
- Mosgatishmëria e donatorëve potencialë për financimin e projekteve investive;
- Fatkeqësitë natyrore etj.

Qëllimet, bjektivat strategjike afatgjata dhe afatshkurtëra

KRU-B funksionon me vendim-marrje dhe llogaridhënie nga **Bordi i Drejtorëve (BD)**, në përputhshmëri me parimet e qeverisjes së përbashkët.

BD, duke përfshirë Drejtorët Jo-Ekzekutiv dhe Drejtorët / Zyrtarët Ekzekutiv, për të gjitha aktivitetet bazë, për një periudhë më afatgjatë (deri në 2028) ka përcaktuar qëllimet kryesore strategjike si në vijim:

- Zgjerimin e zonës së shërbimit deri në 98%;
- Rritjen e kohëzgjatjes së furnizimit me ujë të konsumatorëve për 24 orë;
- Sigurimin e shfrytëzimit racional të burimeve të ujit;
- Adoptimin e rregulloreve të ARRU, përfshirë atë të Standardeve Minimale të Shërbimeve, Kartën e Konsumatorëve, Politikën Tarifore dhe të tjera, për sigurimin cilësor të shërbimeve si dhe arritjen e të ardhurave të mjaftueshme që do të mund të mbulojnë shpenzimet operative dhe investimet e domosdomshme vjetore që do të dalin nga planifikimi;
- Përmirësimin e cilësisë së ujit të pijes, në pajtim me standardet e IKShP, me 100% të pajtueshmërisë së testeve të ujit;
- Promovimin e marrëdhënieve të mira me konsumatorë;
- Krijimin e një ambienti të favorshëm të punës për të gjithë të punësuarit;
- Regjistrimin dhe ruajtjen elektronike të të dhënave dhe informacioneve të KRU-B dhe organizimin e tyre në një sistem informativ menaxhues gjithëpërfshirës

Është planifikuar që qëllimet strategjike afatgjata të lartpërmendura të realizohen duke shfrytëzuar burimet e KRU-B, por edhe përmes mbështetjes nga institucionet e Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe donatorët aktual, sikurse janë Qeveria Zvicerane, Bashkimi Evropian, etj.

Deri në vitin 2025 KRU-B ka paraparë përmbushjen e objektivave strategjike deri në nivelin në vijim:

- Rritjen e kontinuitetit të furnizimit me ujë të pijshëm në 24 orë;
- Zvogëlimin UPF deri në 49%;
- Vazhdimin e faturimit të konsumatorëve me ujëmatësia 100%;
- Rritjen e shkallës së arkëtimit në 93%;
- Ngritjen e normës së mbulesës së punës në 1.28;
- Ngritjen e normës së punës në 1.37;
- Rritjen e efikasitetit të stafit në 5.38.

Objektivat strategjike të planifikuara për arritje e këtyre caqeve janë ndar si në vijim:

Objektivi strategjik 1:

- Zvoglimi i humbjeve të ujit dhe rritja e te hyrave përmes rritjes së arkëtimit dhe zvoglimit të borxheve
- **Objektivat specifikë të propozuar:**
- *Objektivi specifik 1.1. Zvoglimi i humbjeve komerciale;*
- *Objektivi specifik 1.2. Zvoglimi i humbjeve Teknike;*
- *Objektivi specifik 1.3. Zvoglimi i borxheve;*

Objektivi strategjik 2:

- Përmirësimi i marrëdhënieve me publikun (MP) përmes rritjes së cilësisë së shërbimeve dhe ofrimi i cilësisë së lart të ujit.
- **Objektivat specifikë të propozuar:**
- *Objektiva specifike 2.1. Rritja e cilësisë së shërbimeve dhe ofrimi i cilësisë së lart të ujit;*
- *Objektiva specifike 2.2. Planifikimi dhe menaxhimi i rreziqeve;*

Objektivi strategjik 3:

- Përmisimi i menaxhimit të aseteve (të gjeturat e Auditorit)

Objektivat specifikë të propozuar:

- *Objektivi specifik 3.1. Perditësimi i aseteve dhe LL/A;*

Objektivi strategjik 4:

- *Rritja e inovacionit në ndërmarrje ;*
- **Objektivat specifikë të propozuar:**
- *Objektivi specifik 4.1. Rritja e shërbimeve elektronike;*
- *Objektivi specifik 4.2. Implementimi i sistemeve të reja softverike;*

1. Vlerësimi i performancës së vitit paraparak 2022

Gjatë vitit 2022 (duke ju referuar të dhënave aktuale për nëntë muajt e parë të vitit dhe atyre të vlerësuara për tre muajt e fundit) KRU-B ka performuar më mirë në disa prej treguesve kryesor, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2021.

Gjatë vitit 2022, KRU-B ka kryer të gjitha aktivitetet e rregullta operative, duke përfshirë furnizimin e rregullt me ujë të pijes, grumbullimin e ujërave të ndotura dhe aktivitetet tjera operative dytësore, si dhe në përgjithësi, ka arritur të pëmbush disa, por jo të gjitha objektivat e parapara në Planin e Biznesit 2022-2024 për të njëjtën periudhë. Punëtorët kanë performuar, kryesisht, në bazë të përshkrimit të punës dhe në raste është aplikuar sistemi i shpërblimit të performancës së mirë (sidomos në sektorin e shitjes).

Aktualisht, KRU-B është duke përdorur sisteme relativisht të avancuara të menaxhimit të informacioneve.

Aplikacioni i të dhënave financiare	Aplikacioni i të dhënave të relacionit me konsumatorë	Aplikacioni i të dhënave të resurseve njerëzore	SCADA në trajtim	SCADA në shpërndarje	GIS dhe mirëmbajtje
E avancuar			Mesatarisht e avancuar		

1.1 Shërbimi operativ - teknik

Gjatë vitit 2022, KRU-B, ka arritur të sigurojë ujë të pijes mesatarisht për rreth 22 orë në ditë. Mungesat e ujit kanë qenë kryesisht gjatë orëve të ditës në nën-zonat e shërbimit, të cilat i nënshtrohen reduktimeve të planifikuara (Komogllavë, Gurëz, Muhoc, Lloshkobare, Kosinë, Slivovë, Koshare, Tërn, Fshati i Vjetër dhe Bibaj).

Për trajtimin e ujit të pijes është shfrytëzuar **Impianti i Trajtit të Ujit të Pijes (ITUP)** në Pleshinë dhe 15 (pasëmbëdhjetë) sisteme të thjeshta trajtuese të klorinimit të ujësllësve të zonave rurale. Nga të gjitha këto sisteme trajtimi janë trajtuar rreth 8.580.043 m³ ujë të prodhur. KRU-B ka arritur të realizojë mirëmbajtjen e rregullt të sistemit të ujësllësit dhe kanalizimit, përkundër përballjes me problemet e sjellura nga rrjeti i ujërave atmosferik, sidomos gjatë stinës së pranverës.

Cilësia e ujit të pijes, të shpërndarë në tërë zonën e shërbimit, është mbikëqyrë rregullisht nga IKShPK dhe rezultatet e ujit të furnizuar janë relativisht të kënaqshme. Sipas të dhënave të siguruar nga IKShPK, në nivel të kompanisë, mesatarisht për dhjetë muajt e parë të vitit 2022, përputhshmëria e testeve bakteriologjike të ujit ka qenë 98.50%, ndërsa përputhshmëria e testeve fiziko-kimike ka qenë 94.50%. Kryesisht Hani i Elezit ka bërë që të bie përqindja e testeve. Sipas interpretimit të zyrtarëve të IKShPK, uji i shpërndarë nga KRU-B, në vitin 2022, në përgjithësi, ka qenë i sigurtë për pije.

Gjatë vitit 2022, Sektori i Humbjeve Teknike të Ujit ka vazhduar punën në terren për zvoglimin e këtyre humbjeve, duke hulumtuar rrjedhjet e ujit në tërë zonën e shërbimit, me theks të veçantë në qytetin e Ferizajit dhe DMA zonave. Njëkohësisht, KRUB ka punuar edhe në drejtim të zvogëlimit të humbjeve komerciale të ujit, përmes aktiviteteve gjatë muajve qershor – tetor, të cilat kanë pasur të bëjnë, kryesisht me identifikimin e lidhjeve ilegale. Rezultatet kanë qenë pozitive prandaj, ky aktivitet do vazhdojë edhe në të ardhmen.

Përkundër aktiviteteve të lartë përmendura gjatë vitit 2022, KRU-B ka arritur që të ulë përqindjen e UPF prej 56.95% në 52%. Pjesën më të madhe të këtyre humbjeve e përbëjnë humbjet teknike dhe komerciale, humbjet komerciale/administrative gjatë muajve të verës, por një pjesë të konsiderueshme të këtyre humbjeve e përbëjnë edhe humbjet teknike/fizike-rrjedhjet e shpeshta në rrjetin e ujësllësit, prej përafërsisht 68 të tilla në muaj.

1.2 Financat dhe shërbimi i shitjes

Gjatë vitit 2022, krahasuar me fundin e vitit 2021 numri i konsumatorëve të regjistruar është rritur për 2,556, kjo si rezultat i: (i) lidhjeve të reja në sistemin e furnizimit me ujë; (ii) zbulimit të konsumatorëve ilegalë dhe (iii) aktivizimin e konsumatorëve pasiv në bazën e të dhënave të konsumatorëve.

Arkëtimi ka arritur vlerën më të lartë në 2022, si rezultat i politikave të reja të ndërmarra nga menaxhmenti i kompanisë. Ndër këto politika të zbatuara që kanë dhënë rezultat, është edhe pralajmërimi i angazhimit të përmbaruesve në arkëtimin e borxheve. Mirëpo, edhe përkundër përpjekjeve të lartëpërmendura, arkëtimi i të ardhurave ende nuk ka arritur nivelin e dëshiruar. Dështimi në arkëtimin e borxheve ka ndodhë, kryesisht në zonat rurale. KRU-B konsideron se faktorët kryesor që kanë mundur të ndikojnë në këtë gjendje janë edhe gjendja ekonomike e një shtrese të popullsisë, covid-19 si dhe inflacioni.

Me të ardhurat e arkëtuara është bërë e mundur të mbulohen shpenzimet operative të kompanisë. Norma e mbulesës së punës për vitin 2022 ka qenë mesatarisht 1.49, që nënkupton se me të ardhurat e arkëtuara mund të mbulohen të gjitha shpenzimet operative (pa amortizim). Mirëpo, përkundër rritjes së vlerës së arkëtimin, kërkesat (llogaritë arkëtuese) ndaj konsumatorëve janë rritur gradualisht.

Gjatë vitit 2022 KRU-B ka punuar në ngritjen e cilësisë së shërbimeve, sidomos atë të marrëdhënieve me konsumatorë (zgjidhjen e ankesave). Numri i ankesave për rreth 28 dhe kërkesave për rreth 175 për muaj, që mund të interpretohet si rritje e besimit të konsumatorëve ndaj kompanisë.

1.3 Burimet njerëzore

Gjatë vitit 2022 në KRU-B nuk kanë ndodhur ndryshime të dukshme në strukturën organizative, numri i stafit vazhdon të jetë afërsisht i njejt. Kanë vazhduar trajnimet për stafin menaxherial dhe atë teknik nga projektet mbështetëse dhe nga **Shoqata e Ujësjetësve të Kosovës (ShUKOS)**. Menaxhmenti i KRUB konsideron se kapacitetet njerëzore të kompanisë nuk janë ende në nivelin e kërkuar, sa i përket anës profesionale. Këto aspekte të stafit do të adresohen gjatë viteve planifikuese 2023 - 2025.

2. Plani Operativ

2.1 Parashikimi i kërkesës për ujë të pijes dhe për grumbullim - trajtim të ujërave të ndotura

Edhe për periudhën planifikuese 2023 - 2025, KRU-B do të siguron shërbime të ujësjellësit dhe grumbullimit të ujërave të ndotura në regjionin e komunave Ferizaj, Kaçanik dhe Hanin e Elezit, duke u përpjekur maksimalisht që gjatë kësaj periudhe kohore ta shtrijë veprimtarinë e vet edhe në Komunën e Shterpcës

Duke u bazuar në diskutimet me personat përgjegjës në komunat e zonës së shërbimit, lidhur me mundësinë e rritjes së numrit të konsumatorëve shtëpiak, biznese dhe institucional duke marr parasysh investimet në sistemet rurale, si dhe faktorë të tjerë, menaxhmenti i KRU-B vlerëson se deri në vitin 2025, në tërë zonën, pritet një rritje e numrit të konsumatorëve shtëpiak me kërkesë për ujë deri në 41,530 nga 37,031 sa janë aktualisht.

Ky shtim i numrit të konsumatorëve do të ndikojë edhe më tutje në rritjen e kërkesës për ujë të pijes, të cilën kërkesë KRU-B do të mund ta përballojë me rritjen e kapaciteteve të cilat i ka planifikuar si dhe me zvogëlimin humbjeve të ujit.

Konsiderojmë se deri në fund të vitit 2025 përqindja e mbulimit me shërbime të furnizimit me ujë të pijes do të jetë 85%, ndërsa me grumbullimin e ujërave të ndotura 84%.

Gjatë periudhës planifikuese 2023 - 2025 pritet të shtohet numri i konsumatorëve të regjistruar rreth 4,499, të cilët do të kërkojnë shërbime për ujë të pijes dhe grumbullim të ujërave të ndotura.

Hollësitë lidhur me numrin e konsumatorëve, për secilën kategori të konsumatorëve janë në Planin e Shitjes Shtojca II-(la).

Në llogaritjet për parashikimin e kërkesës për ujë, menaxhmenti i KRU-B ka vendosur norma të diferencuara të kërkesës për ujë, të shprehura në m³ për konsumatorë në muaj, për secilën nga tri kategoritë e konsumatorëve (shtëpiak, biznese dhe institucione), për të tre vitet planifikuese, që reflektojnë një vlerësim të shfrytëzimit të ujit, sipas kategorive të konsumatorëve.

Normat e përzgjedhura të kërkesës për ujë që janë përdorur në këtë Plan Biznesi, **bazohen në llogaritjet e shfrytëzimit të ujit në vitin bazë 2022**, si dhe për llogaritjet e konsumit optimal të ujit. Normat e shfrytëzuara gjatë planifikimit janë paraqitur në tabelën në vijim:

Kategoritë	Njësia	Periudha			
		2022	2023	2024	2025
Shtëpiak (aktiv)	m ³ /vit	Normat për këtë vit janë huazuar nga Plani i Biznesit 2022 - 2024	115	115	116
Shtëpiak (pasiv)	m ³ /vit		0	0	0
Biznese (aktiv)	m ³ /vit		100	100	110
Biznese (pasiv)	m ³ /vit		0	0	0
Institucione (aktiv)	m ³ /vit		860	860	660
Institucione (pasiv)	m ³ /vit		0	0	0

Tabela 1. Normat e kërkesës për ujë sipas kategorisë së konsumatorëve

Sipas për llogaritjeve të bëra, rezulton se kërkesa e përgjithshme për ujë të pijes për periudhën planifikuese është:

Përshkrimi	Njësia	Periudha		
		2023	2024	2025
Kërkesa për ujë	m ³ /vit	4,399,647	4,588,751	4,788,794

Tabela 2. Kërkesa për ujë të pijshëm

2.2 Trajtimi, cilësia dhe shpërndarja e ujit të pijes

Menaxhmenti i KRU-B mbetet i përkushtuar të plotësojë standardin e shërbimit për vazhdueshmërinë e furnizimit të konsumatorëve me ujë të pijes në kohëzgjatje prej 24 orëve, **duke shfrytëzuar kapacitetin maksimal prodhues dhe trajtues të ITUP-Pleshinë, ITUP-Talinoc, të sistemeve prodhuese dhe trajtuese të ujësjellësve të zonave rurale në Ferizaj, Kaçanik dhe H. e Elezit** (shiko tabelën 3.).

Emërtimi i Impiantit	Vendndodhja	Lloji i trajtimit (fizik, biologjik, kimik)	Kapaciteti maksimal, m3/vit	Kapaciteti shfrytëzues, m3/vit
FPU në Pleshinë	Pleshinë	fizik, kimik	6,874,848	5,518,800
FPU në Pleshinë	Pleshinë	fizik, kimik	0	0
FPU në Pleshinë	Pleshinë	fizik, kimik	0	0
FPU në Pleshinë	Pleshinë	fizik, kimik	0	0
Sistem klorimi	Varosh	kimik	473,040	315,360
Sistem klorimi	Gërlisë	kimik	214,445	186,624
Sistem klorimi	Softaj	kimik	68,429	62,208
Sistem klorimi	Mirash	kimik	62,208	46,656
Sistem klorimi	Cërnillë	kimik	189,216	166,973
Sistem klorimi	Babush	kimik	186,624	155,520
Sistem klorimi	Bablak	kimik	110,376	93,312
Sistem klorimi	Muhoc	kimik	93,312	74,650
Sistem klorimi	Kosinë	kimik	236,520	186,624
Sistem klorimi	Dramjak	kimik	252,288	189,216
Sistem klorimi	Kaçanik	kimik	630,720	615,859
Sistem klorimi	Kaçanik	kimik	141,912.00	124,416
Sistem klorimi	Kaçanik	kimik	186,624.00	155,520
FPU	Hani i Elezit Dimc	kimik	630,720.00	378,432
Sistem klorimi	Hani i Elezit	kimik	220,752.00	189,216
Sistem klorimi	Greme	kimik	409,968.00	346,896
Sistem klorimi	Neredime	kimik	0.00	0
Sistem klorimi	Balaj	Kimik	0.00	0
Sistem klorimi	Manastirc	kimik	0.00	0
Sistem klorimi	Gaçke	kimik	0.00	0
FPU	Talinoc	kimik	1,576,800.00	1,103,760
Gjithsej			12,558,802	9,910,043

		2023	2024	2025
Mesatarja vjetore e kapacitetit prodhues	m3/vit	9,910,043	9,433,810	9,433,810

Tabela 3. Kapacitet maksimal, kapaciteti maksimal shfrytëzues mesatarja vjetore e planifikuar e prodhimit dhe trajtimit të ujit të pijes-kontrollimi i ujit të shpërndarë

KRU-B synon që ta rritë kontrollin e shpërndarjes së ujit të trajtuar, së pari përmes identifikimit të komponentave të UPF dhe për këtë qëllim, si pikënisje do të përdoret Modeli i Balancit të Ujit me të dhënat e 2022. Shiko tabelën në vijim.

Balanci i Ujit në m3 për periudhën prej **365** ditë

Vëllimi Hyrës në Sistem 8,480,043 m3 Margjina e Gabimit [+/-] 0.0%	Konsumi i Autorizuar 4,165,403 m3 Margjina e Gabimit [+/-] 0.2%	Konsumi i Autorizuar i Faturuar 4,024,303 m3	Konsumi i Matur i Faturuar 4,024,303 m3	Uji i Faturuar 4,024,303 m3
			Konsumi i Pa-matur i Faturuar 0 m3	
	Humbjet e Ujit 4,314,640 m3 Margjina e Gabimit [+/-] 0.2%	Konsumi i Autorizuar i Pa-faturuar 141,100 m3 Margjina e Gabimit [+/-] 6.5%	Konsumi i Matur i Pa-faturuar 4,500 m3	Uji i Pa-faturuar 4,455,740 m3 Margjina e Gabimit [+/-] 0.0%
		Humbjet Komerciale 2,408,041 m3 Margjina e Gabimit [+/-] 5.3%	Konsumi i Pa-matur i Pa-faturuar 136,600 m3 Margjina e Gabimit [+/-] 6.8%	
			Humbjet Fizike 1,906,599 m3 Margjina e Gabimit [+/-] 6.7%	
		Pasaktësitë e Ujëmatësve të Konsumatorëve dhe Gabimi në Trajtimin e të Dhënave 1,006,076 m3 Margjina e Gabimit [+/-] 10.0%		

Tabela 4. Balanci i ujit për 2022 (365 ditë)

Siç shihet edhe në tabelën më lartë, niveli i UPF që përfshinë humbjet teknike/fizike dhe komerciale/administrative është i lartë prandaj, KRU-B do të përqëndrohet me tërë stafin respektiv për të zvogëluar këtë tregues deri në 55.6% për vitin 2023, gjë që do të reflektohet në sasi të shtesë të ujit me të cilat mund të kënaqen kërkesat momentale për ujë, sepse në shumicën e rasteve uji i keqpërdorur është konsumuar në sasi të mëdha për ujitje apo qëllime të tjera. Ky zvogëlim i UPF do të ndikonte poashtu edhe në zvogëlimin e kostos për ujin e shitur, si dhe në rritjen e të ardhurave.

Me qëllim të kontrollimit dhe zvogëlimin të UPF, KRU-B do të merr masat si në vijim:

1. Mobilizimin e njësive të kontrollit në terren për identifikimin e:

- (i) Konsumatorëve fiktiv (dikur të regjistruar si konsumatorë të KRU-B);
- (ii) Konsumatorëve pasiv;
- (iii) Shfrytëzimit të paligjshëm të ujit nga konsumatorët e regjistruar (lidhjet by-pass);
- (iv) Konsumatorëve të pa-autorizuar (ilegal);
- (v) E saktësisë së leximit të ujëmatësve dhe
- (vi) Ujëmatësve jo-funksionalë.

Këto të dhëna pastaj do të futen në hartat kadastrale në **Sistemin e Informacionit Gjeografik (SIGJ-angl Geographic Information System-GIS)** dhe në bazën e të dhënave të konsumatorëve. Gjatë tërë periudhës planifikuese pritet të identifikohen konsumatorë ilegal, nga të cilët pritet të rritet faturimi i ujit për rreth 45,500 m3 në vit gjë që do të rezultojë drejtëpërdrejtë në uljen e UPF.

2. Riorganizimin e ekipeve, me qëllim të hulumtimit të rrjedhjeve fizike/teknike të ujit, duke filluar nga zonat më problematike. Ky aktivitet do të përfshijë veprimet „që nuk kanë kosto”, siç janë:

- (i) Inspektimet e rregullta të rrjetit,
- (ii) Inspektimet e rregullta të konsumatorëve dhe
- (iii) Mbajtjen e shënimeve për kostot e riparimit të rrjedhjeve ose për mirëmbajtjen e hartave të shpeshësisë së rrjedhjeve.

Poashtu, do të krijohet një njësi e veçantë për riparimin e rrjedhjeve sipërfaqësore, e cila do të veprojë paralel me njësinë e rregullt të mirëmbajtjes. E njëjta njësi do të angazhohet edhe në identifikimin dhe riparimin e rrjedhjeve nëntokësore të ujit si dhe do të angazhohen ekipe kujdestare 24/7.

Metodat e parapara për detektimin e rrjedhjeve nëntokësore do të jenë:

-Përdorimi i detektorëve sonik – si ndër metodat më të sofistikuar për gjetjen dhe lokalizimin e rrjedhjeve në instalimet e ujësjellësit. Pajisjet përbëhen nga njësia qendror proceduese, dy sensorë me ndjeshmëri të lartë për pranimin e vibrimeve nga rrjedhjet dhe dy radio transmetues. Sensorët zakonisht vendosen në pjesët metalike me qasje në rrjet, siç janë hidrantët, kapakët etj. Dhe

-Inspektimi vizuel i pusetave të kanalizimit gjatë periudhës së natës kur shpenzimi i ujit është shumë i vogël.


3. Vazhdimin e përkrahjes nga Qeveria e Kosovës dhe asaj Zvicerane, përmes projekteve mbështetëse teknike dhe institucionale. Gjatë vitit 2023 do të vazhdohet puna në pilot zonat tashmë të ndara në regjionin e Ferizajt, me aktivitetet kryesore si:

- (i) Përdatësimin e informacioneve bazike të konsumatorit ose pikës faturuese;
- (ii) Instalimin e ujëmatësve zonalë dhe perzgjedhja e zonave të reja DMA;
- (iii) Ndërtimin e pusetave dhe instalimin e ujëmatësve të konsumatorëve shtëpiak, bizneseve dhe instituconeve dhe
- (iv) Identifikimin dhe regjistrimin e lidhjeve ilegale.

Të gjitha këto aktivitete vlerësohet se do të ndikojnë në zvogëlimin e UPF për më shumë se 3%.

4. Vazhdimin e zëvendësimit të gypave të ujësjellësit në disa rrugë në Ferizaj dhe Kaçanik.

Pas ndërmarrjes së këtyre aktiviteteve pritet që UPF të jetë në 49.2% deri në fund të vitit 2025. Ky tregues në vlera absolute është paraqitur në figurën në vijim. Ndërsa, hollësitë e të gjitha aktiviteteve të lartëpërmendura janë të paraqitura në Shtojcën II të këtij dokumenti, në formë të planeve konkrete të veprimeve që planifikohen të ndërmerren gjatë vitit 2023.



Diagrami 1. Planifikimi i trajtimit dhe shitjes së ujit të pijes

2.3 Cilësia e ujit të shpërndarë

KRU-B do të vazhdojë të kujdeset që uji të trajtohet sipas standardeve të cilësisë së ujit, të përcaktuara nga IKShPK dhe në këtë mënyrë synohet të arrihet pajtueshmëria prej 100% me standardet e ujit të pijshëm në Kosovë.

Gjatë vitit 2023 mbikëqyrja operationale e cilësisë së ujit (përfshinë analizat e ujit nga burimi deri tek konsumatori), planifikohet të realizohet në laboratorin e ITUP në Pleshinë.

Kjo mbikëqyrje do të përfshijë kontrollimin e cilësisë së ujit në të gjitha pikat e zonës së shërbimit dhe KRU-B do të intervenojë menjëherë në rastet kur identifikohen problemet. Paralel me këtë, IKShPK do të vazhdojë me mbikëqyrjen e përputhshmërisë së cilësisë së ujit përmes testimit të mostrave të ujit të nxjerrura nga pikat të ndryshme të furnizimit të KRU-B, sipas programit të mbikëqyrjes.

Gjatë periudhës së **tre mujorit të parë (TM1)** 2023, pritet që laboratorin të akreditohet nga Drejtoria e Përgjithshme për Akreditim të Kosovës. Kompletimi i procesit të akreditimit të laboratorit do të bëhet në përputhje me standardin ISO/IEC 17025:2017.

Duke u bazuar në kërkesat e fundit nga IKShPK, gjatë viteve në vijim, KRU-B do të hartoj-përditësoj:

- Planet Operative të Monitorimit të cilësisë së ujit bazuar në analizën e rrezikut;
- Raportin Vjetor për cilësinë e ujit të pijshëm;
- Planet e Sigurisë së Ujit për secilin prej burimeve të ujit në shfrytëzim;

2.4 Grumbullimi i ujërave të ndotura

Gjatë periudhës planifikuese 2023, KRU-B do të vazhdojë të ofrojë shërbimet e grumbullimit të ujërave të ndotura të pjesëve urbane të komunave: Ferizaj, Kaçanik dhe Hanit të Elezit. Ujërat e ndotura do të vazhdojnë të derdhen në lumenjë-përrocka, pa ndonjë trajtim.

Gjatë vitit 2023, planifikohet të investohet më tepër në mirëmbajtjen e rrjetit të kanalizimit me mjetet vetanake të kompanisë, përkatësisht me rreth 113,000 €. Poashtu, gjatë këtij viti planifikohet pastrimi i rregullt dhe gradual i rrjetit dhe pusetave të kanalizimit që do të rezultojë në zvogëlimin e numrit të bllokimeve në kanalizim me përfaqësim për 20% më pak se në vitin 2022. KRU-B planifikon që këtë aktivitet të kryej në bashkëpunim edhe me komunat përkatëse, sepse rrjeti i kanalizimit është i përzier me rrjetin e ujërave atmosferike, të cilat menaxhohen dhe mirëmbahen nga qeveritë komunale.

3.Plani i shitjes

Në nën-kapitullin 2.1 është elaboruar plani i zgjerimit të zonës së shërbimit (shtimi i numrit të konsumatorëve). Ndërsa, tabela në vijim tregon në hollësi prejardhjen e rritjes së numrit të konsumatorëve, sipas viteve dhe aktiviteteve bazë të KRU-B (ujë të pijshëm dhe grumbullim të ujërave të ndotura).

Aktivitetet biznesore	Periudha		
	2023	2024	2025
<i>Uji i pijshëm (#)</i>			
Konsumatorët e rinj	1,543	1,948	1,008
Legalizimi i konsumatorëve ilegal	150	130	120
Kyçje në NJO Ferizaj	693	1218	736
Kyçja e 7 fshatrave në Ferizaj	350	100	50
Kyçje në NJO Kaçanik	100	250	87
Kyçje në NJO Han të Elezit	250	250	15
<i>Grumbullimi i Ujërave të ndotura (#)</i>			
Konsumatorët e rinj	1,573	1,326	1,962
Legalizimi i konsumatorëve ilegal	150	130	120
Kyçje në NJO Ferizaj	723	1036	1540
Kyçja e 7 fshatrave në Ferizaj	350	40	50
Kyçje në NJO Kaçanik	100	50	187
Kyçje në NJO Han të Elezit	250	70	15

Tabela 5. Rritja e numrit të konsumatorëve gjatë 2023 – 2025

Siç është paraqitur edhe në tabelën më lartë, numri i konsumatorëve të rinj do të shtohet në tërë regjionin, mirëpo ky numër pritet të jetë më i ulët se viteve paraprake duke u bazuar në një dinamikë më të ulët të ndërtimeve të reja krahasuar me vitet e fundit. Ndërsa ujësjellësat rural në (i) 7 fshatra (Balaj, Greme, Rakaj, Manastircë, Nerodime e Epërme, Nerodime e Poshtme, Sojevë, Dardani, Zllatar) do të integrohen gjate viteve ne vijim në Ferizaj; (ii) 5 fshatra (Reke, Dubrave....) në Kaçanik do te integrohen gjatë vitit 2023, gjithashtu (iii) fshati Gorancë dhe gjysma e qytetit Hani i Elezit. Këto sisteme rurale do të menaxhohen nga KRU-B në bazë të një Memorandumi të Mirëkuptimit të nënshkruar tashmë bashkë me Komunitatet përkatëse nën mbikëqyrjen e kompanisë implementuese të Programit përkatës. Poashtu, në tabelë prezantohet një rritje prej 400 e konsumatorëve ilegal që do të mund të identifikohen dhe rrjedhimisht të legalizohen përmes procesit të rregullt ligjor të legalizimit si dhe bazuar në procedurat e brendshme të Kompanisë.

Pas rritjeve të planifikuara më lartë, numri total i konsumatorëve, duke përfshirë të tri kategoritë e konsumatorëve, sipas shërbimeve të ofruara, gjatë viteve 2023-2025 do të jetë:

Aktivitetet biznesore	Njësia	Periudha		
		2023	2024	2025
Uji i pijes	Nr.	38,574	40,522	41,530
Grumbullim i ujërave të ndotura	Nr.	33,633	34,959	36,921

Tabela 6. Numri i përgjithshëm i konsumatorëve 2023 – 2025, sipas aktiviteteve shërbyese

Aktivitetet bazë të cilat do të vazhdojnë të ndërmerren edhe gjatë periudhës planifikuese janë:

3.1 Përdatësimi i bazës së të dhënave

Gjatë periudhës 2023 planifikohet mobilizimi i njësive të lexuesve për të bërë mbledhjen e të dhënave në teren me qëllim të përdatësimit të të dhënave për konsumatorët ekzistues. Poashtu, KRU-B planifikon të ndërmerr aksionin e nënshkrimit të kontratave me konsumatorët ekzistues dhe ata të rinj.

Siç është theksuar edhe më lartë lidhur me UPF, shërbimi i shitjes do të ndërmerr masat e verifikimit të të gjithë konsumatorëve pasiv dhe të aktivizimit të menjëhershëm të atyre që do të identifikohen si aktiv.

Gjatë vitit 2023 do të vazhdohet me aktivitetin e identifikimit të lidhjeve ilegale. Njësitë teknike dhe shërbimi i shitjes do të bashkëpunojnë ngusht për gjetjen dhe regjistrimin e konsumatorëve ilegal. Gjatë fushatës, do t'iu bëhet me dije konsumatorëve ilegal përballja me sanksionet ligjore. Ndërsa, konsumatorët e identifikuar do të regjistrohen në bazën e të dhënave të KRU-B.

3.2 Instalimi i ujëmatësve

Gjatë periudhës 2023 – 2025, KRU-B planifikon të instalojë/zëvendësojë rreth 1,500 ujëmatës për konsumatorët ekzistues, ndërsa pjesa tjetër do të financohen nga vetë konsumatorët, të cilët do të lidhen si konsumatorë të ri në sistemin ekzistues të ujësjellësit dhe kanalizimit.

Poashtu, KRU-B do të përkujdeset që të gjithë ujëmatësit e rinj të instaluar të jenë komform standardeve të përcaktuara nga **Ministria e Tregtisë dhe Industrisë (MTI)** – Agjensioni i Metrologjisë.

3.3 Rritja e saktësisë së leximit të ujëmatësve

Me qëllim të rritjes së saktësisë së leximit të ujëmatësve, KRU-B do të mobilizojë njësinë e kontrollit për të inspektuar gjendjen në terren lidhur me saktësinë e deritashme të leximit të ujëmatësve dhe gjendjen funksionale të tyre. Gjatë vitit 2023, njësitë e kontrollit do të aktivizohen gjatë gjithë kohës ndërsa në vitet në vijim do të angazhohen vetëm kohë pas kohe për të kontrolluar saktësinë e leximit të ujëmatësve. Në rastet e gjetjes së parregullsive, KRU-B do të ndërmerr masat ndëshkuese ndaj lexuesve të papërgjegjshëm ashtu siç kemi ndërmarr edhe gjatë viti 2022.

Gjatë vitit 2023 do të shikohet mundësia e zbatimit të pilot të projektit të faturimit mobil, e cila besohet se do të sjell rezultate më të mira (më të sakta) në lexim dhe uljen e UPF-së.

3.4 Faturimi

Faturimi për shërbimet e realizuara do të vazhdojë sipas procedurave të brendshme të kompanisë, duke u bazuar në lexim. Faturimi do të vazhdojë të bëhet përmes modulit të faturimit të paketës së tanishme softverike. Ky modul, ndër të tjera posedon edhe aplikacionin e paralajmërimit të gabimeve gjatë leximit apo futjes së tyre në modul. Faturat do të vazhdojnë të shtypen në baza mujore.

Pas marrjes së masave të paraqitura më lartë, gjatë periudhës planifikuese krahasuar me periudhën paraprake, pritet të rritet vlera reale e faturimit.

3.5 Arkëtimi

Për periudhën 2023 KRU-B planifikon që së pari ta rritë vlerën reale të të ardhurave të faturuara e pastaj edhe efikasitetin e arkëtimit (vlerat në terma absolute dhe relative janë të siguruara në Shtojcën Ia dhe Ib).

Me qëllim të rritjes së normës së arkëtimit do të ndërmerren veprimet si në vijim:

- Fushatë për vetëdijësimin e qytetarëve, e cila do të realizohet përmes kanaleve të informimit dhe reklamimit;
- Ndjekja e rregullores së kompanisë për arkëtimin e borxheve të vjetra, duke realizohen takime me secilin konsumatorë veç e veç;
- Kërkesë institucioneeve relevante për rimbursimin e arkëtimit për rastet sociale, në zbatim të vendimit përkatës të Qeverisë,
- Marrja e masave të shkëputjes nga lidhja individuale për konsumatorët e pa ndërgjegjshëm, në bazë të rregullores përkatëse të ARRU dhe procedurave të brendshme të kompanisë dhe
- Procedurat përmbarimore.

3.6 Marrëdhëniet me konsumatorë

KRU-B do të angazohet në vazhdimësi të përmirësojë dhe shpejtojë procesin e shqyrtimit të ankesave të konsumatorëve, njoftimin e tyre nëpërmjet sms mbi statusin e ankesave të tyre, funksionalizimin e qendrës së thirrjeve dhe lansimin e numrit pa pagesë për lajmërimin e keqpërdorimeve, planifikohet edhe trajnim i stafit të cilët janë të angazhuar drejtëpërdrejtë në këtë proces dhe avancimin e modulit të marrëdhënieve me konsumatorë duke lidhur me qendrën e thirrjeve.

3.7 Komunikimi me publikun

KRU-B do të angazohet në përmirësimin e komunikimit me publikun e gjërë, përmes pjesëmarrjes së stafit (tashmë të përzgjedhur) të kompanisë në mediat lokale dhe vendore. Do të përdatësohet në vazhdimsi edhe uebfaqja e kompanisë, për të përfshirë edhe të rehat ditore/javore, si dhe do të përmirësohet më tutje komunikimi i drejtëpërdrejtë me konsumatorët, përmes postës elektronike, sms-ve dhe rrjeteve sociale.

Hollësitë e të gjitha aktiviteteve të përmendura në këtë kapitull janë në dokumentin Strategjia e Komunikimit.

4.Plani i financave

